

Sektori i Kujdesit Social & Njësise së Mbrojtjes së Fëmijeve

Sektori mbulon këto çeshtje:

- a. Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijeve
- b. Qendrat Komunitare (QENDRA MULTIDISCIPLINARE TE MALTESER; QENDRA E ZHVILLIMIT DITOR LEZHË; QENDRA E MOSHËS SË TRETË)
- c. Barazia Gjinore dhe Dhuna në Familje
- d. Strehimi Social

a. Baza ligjore e Njësise se Mbrojtjes se Femijeve

Ligji nr 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Ligji nr 37/2017 “Kodi I drejtësisë penale për të mitur.

Ligji nr 9062, datë 08.05.2003 “Kodi I familjes”

Ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror “

Ligji nr 8116, datë 29.03.1996 i ndryshuar “Kodi i procedurës civile

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve NJMF është përgjegjëse dhe ka për detyrë:

- Të vlerësojë informacionin për fëmijën në rrezik dhe nivelin e rrezikut;
- Të Vlerësojë nevojat e fëmijës dhe familjes;
- Të Monitorojë menaxhimin e rasteve të fëmijëve nga PMF(punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve)
- Koordinon funksionimin e GTM;(grupi teknik multidisiplinar)
- Bashkëpunon me çdo strukturë përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
- Organizon takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës;
- Shërben si qendër informacioni;

Masat e Mbrojtjes qe ofron Njesia per mbrojtjen e fëmijëve.

- Masat emergjente (24 ore) të vendosjes së fëmijëve në përkujdesje alternative;

- Vendosje e fëmijës në përkujdesje alternative;
- Mbikëqyrje e specializuar e fëmijës në ambientin familjar.
- Pmf përveç masave mbrojtëse kryen dhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme që lehtësojnë aksesin e fëmijës në të drejtat e tij si dhe shërbimet shoqërore apo shërbime të tjera të nevojshme.

Kategoria e fëmijëve që menaxhohen nga Njmf .

- Menaxhon dhe asiston fëmijët e rikthyer nga emigracioni.
- Menaxhon dhe asiston fëmijët të cilët akuzohen se kanë kryer vepra penale por janë nën moshën për përgjegjësi penale.
- Menaxhon dhe asiston fëmijët që kanë braktisur shkollën dhe në tentative braktisje.
- Menaxhon cdo rast të një fëmijë të abuzuar, dhunuar, neglizhuar.
- Menaxhon dhe trajton rastet e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, (që përdoren për lypje, shitje apo për punë pa mbushur moshën minimale.)
- Menaxhon cdo rast të fëmijëve deri në 18 vjeç të klasifikuara si viktima trafikimi VT dhe viktima të mundshëm trafikimi VMT.
- Asiston cdo fëmijë 0-18 vjeç në gjyaktë.
- Asiston cdo fëmijë 0-18 vjeç në polici.

b. Qendrat Komunitare

Baza ligjore: ligji 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror

Shërbimet

- Identifikimi i hershëm, program i vizitave në familje, promovimi dhe rrjetet informale, shërbimet në lëvizje, seancat informuese.
- Menaxhimi i rastit për mbrojtjen e fëmijës: Identifikimi, referimi, vlerësimi, plani MTD (Ekipi Multi- Disiplinar), shërbimet e bazuara në nevojë, koordinimi dhe ndjekja, monitorimi (manual i menaxhimit të rastit), përfshirë asistencën direkte për rastet me rrezik të mesëm dhe të ulët dhe baza e të dhënave për secilin rast.
- Aktivitete për promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e mbrojtjes së fëmijës

- Pika e informacionit (informacion për shërbimet në qendër dhe në qytet dhe sesi të përfitojmë prej tyre

- *Programe prindërimi*

- Klasat e prindërimit: Disiplinimi pozitiv, praktikat për rritjen e fëmijëve
- Grupet e mbështetjes së prindërimit
- Shërbimet psikosociale
- Këshillimi individual për të rinjtë në rrezik
- Grupe komunitare

- *Programi për zhvillimin e fëmijës*

- Programi për aftësi jetësore
- Aktivitete psikosociale nëpërmjet lojërave
- Programe passhkollori
- Edukimi ndërmjet bashkemoshatareve (sinergji me shkollën si qendër komunitare)
- Ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve

❖ **QENDRA MULTIDISCIPLINARE TE MALTESER**

Sherbimet qe ofrohen :

- Qender ditore per femijet 3-6 vjec
- Programi Afterschool per femije 7-12 vjec
- Aktivitete sportive me femijet e Qendres
- Aktivitete sportive me komunitetin
- Nderhyrje emergjence
- Suport i familjeve ne nevoje (ushqime, medikamente)

❖ **QENDRA E ZHVILLIMIT DITOR LEZHË**

Qendra e Zhvillimit Ditor : ka një staf prej 12 punojësish

Numri gjithësej i përfituesve është 29, ku 23 M dhe 6 f

Të gjithë përfituesit janë me familje dhe nga këto 21 përfitues kanë më shumë se 5 vjet të regjistruar.

6-18 vjec janë 18 përfitues dhe

19-25 vjec janë 11 përfitues

Shërbimet:

Pritja 8 – 8 e 30

8 e 30 – 9 ngrënja e mëngjesit

9-10 procesi socio-edukativ

10-12 pushim, lojra

12-13 dreka

13-16 vazhdim i procesit socio-edukativ dhe zhvillimi i terapive individuale për të ndërgjegjësuar komunitetin mbi shërbimet që ofrohen.

Një herë në muaj dy punonjës të qendrës zhvillojnë aktivitetet ndërgjegjësuese në komunitet dhe në njësitë administrative

Takime informuese me prindërit

Aktivitete për ditët ndërkombëtare/ botërore

Nga e hëna në të enjte procesi i punës është i njëjtë ndërsa të premten përfituesit vetëm argëtohen os zhvillojnë shëthjitje të ndryshme në natyre.

Fokusi kryesor i qendrës është integrimi i personave më aftësi ndryshe me të tjerët nëpërmjet aktiviteteve me nxënës nga shkollat e ndryshme të Lezhës dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Lezhë.

QENDRA E MOSHËS SË TRETË

-Shërbimet që ofrohen:

Çdo dite kafe dhe çaj.

Leximin e shtypit të ditës.

Ndjekjen e programeve ne televizor.

Mundësinë për të punuar në kompjutër.

Lojëra shahu, domino, tavëll, letra etj.

Festohen ditelindje, jane shtruar kokteile,

Çdo të enjte nga ora 9:00- 11:00 shërbim shëndetësor falas.

c. Barazia Gjinore dhe Dhuna në Familje

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”
- Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr. 334, datë 07.02.2011 :Për mekanizmin dhe bashkërendimin e punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Barazia Gjinore: Lehtëson bashkëpunimin e organeve të qeverisjes vendore me organet e qeverisjes qendrore dhe organizatat jo-qeveritare për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore;

1. Mbështet organet e qeverisjes vendore, në pajtimin me kompetencat e tyre që të nxisin dhe krijojnë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat duke hartuar politika, duke ndërmarrë masat e përshtatshme dhe veprimet e nevojshme për eliminimin e diskriminimit gjinor dhe arritjen e barazisë gjinore në trajnim dhe mundësi;
2. Merr pjesë në komisionet për marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë të punonjësve të administratës të Bashkisë, me qëllim që të sigurojë përfaqësim të barabartë gjinor në institucionin dhe nivelin hierarkik përkatës;
3. Mbështet organet e qeverisjes vendore dhe lehtëson bashkëpunimin e ngushtë të tyre me organizatat jofitimprurëse lokale dhe organizma akademike për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme.

4. Inicion dhe merr pjesë active në aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuese për barazinë gjinore të organizuar nga bashkia ose që organizohen në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale (takime, ëorkshope, biseda dhe shkrime në media);
5. Mbledh të dhëna gjinore nga Zyra me një ndalesë dhe Sektori i Shërbimeve Shoqërore dhe bën analizën e tyre për tja bashkangjitur raportit të barazisë gjinore;
6. Harton projektet gjinore që Bashkia zbaton me fondet e veta apo aplikon në agjensi qeveritare dhe joqeveritare;
7. Merr pjesë në vlerësimin nga këndvështrimi gjinor të projekteve kryesore të Bashkisë para miratimit të tyre;
8. Realizon në bashkëpunim me drejtorinë e Bashkisë dhe strukturat përkatëse në me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale e organizatat jo-qeveritare për çështjet e barazisë gjinore dhe mbështet organet e qeverisjes vendore për:

a.Mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinisë, duke respektuar formatin e miratuar nga Keshilli i Bashkisë dhe /apo me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale si autoriteti përgjegjës qëndror;

b.Përgatitjen dhe dhënien e informacionit periodik për aktivitetet e kryera nga Bashkia në kuadrin e promovimit të barazisë gjinore dhe statusit të gruas shqiptare;

10. Jep rekomandime për respektimin e parimit të përfaqësimit të barabartë gjinor në organet e qeverisjes vendore veçanërisht gjatë ngritjes së grupeve të punës, komisioneve e delegacioneve;

11. Harton raportin vjetor të monitorimit të barazisë gjinore bazuar në evidencat vëzhgimet, treguesit e harmonizuar që monitoron Bashkia.

Koordinatori Vendor i Dhunës në Familje: Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 8 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar:

1. Drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor të dhunës;

2. Koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe siguron burime dhe shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme;
3. Shërben si ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale dhe të tjera institucione/organizata referimi për të dhënë informacion për t'i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit të tyre;
4. Asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e UPMM/UMM/UM-ve (Urdhër i Menjëhershëm i Mbrojtjes);
5. Shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe pranë shërbimeve të tjera;
6. Sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni i klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar;
7. Organizon dhe monitoron takimin për menaxhimin e rasteve
8. Përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave;
9. Sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuara nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës;
10. Koordinon organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga strukturat përgjegjëse për dhunën në familje e Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ekipin teknik ndërdisiplinor për personelin tjetër që punon me komunitetin;
11. Harton marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “për masa të dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip, bashkangjitur këtij vendimi, dhe ia propozon ato komitetit drejtues për miratim në parim;
12. Propozon në strukturën e shërbimeve sociale pranë qeverisjes vendore, pranë së cilës funksionon, krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare;
13. Inicion dhe merr pjesë aktive në aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje, të organizuar nga bashkia ose që organizohen në bashkëpunim me Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe shoqërinë civile (takime, ëorkshope, biseda dhe shkrime në media)

Kategoritë që përfitojnë:

- Arritja e barazisë gjinore duke eliminuar diskriminimin ndaj grave
- Gra/burra viktime të dhunës në familje

Kujdes të vecantë sidomos për kategoritë vulnerabël që përfshihen; gra kryefamiljare, persona me aftësi të kufizuarm komuniteti LGBTI.

Cfarë ofron:

- Monitorim të rasteve të dhunës
- Vlerësim i emergjencës së rasteve të informuara nga struktura ose OJF=të
- Shoqërim pranë shërbimeve (në institucione të ndryshme)
- Ruajtja e dokumentacionit për cdo rast
- Shërbim psiko-social-ekonomik
- Shërbim ligjor
- Koordinim të veprimeve mes aktorëve
- Realizim të aktiviteteve ndërgjegjësuese

Në tabelle hidhen kodet si më poshtë

<u>1. SEKSI</u>		<u>2. GJENDJA CIVILE</u>		<u>3. FAMILJARET</u>		<u>4. PUNESIMI</u>	
Mashkull	M	Beqar/e	1	Aplikanti	00	Punësuar në shtet	01
Femër	F	i/e martuar	2	nëna/baba	01	Punësuar në privat	02
Nuk		i/e ve	3	Bashkëshorti/ja	02	Vetëpunësuar	03
Pergjigjem	N	i/e divorcuar	4	bir/bija	04	Punësim i rastit	04
				gjysh/e	05	I përfshirë në programin e ndihmës ekonomike	05
				nip/mbesë	06	I përfshirë në programin e pagesës së papunësisë	06
				Vjerri/a	07	Të tjerë.	07
				Dhëndri/nusja	08		
				Vëllai/motra	09		
				Kunati/a	10		
				Të tjerë	11		

Shënim: Në kolumnat 1,2,3, dhe 4 vendos numrin që i korespondon gjëndjes suaj. Të dhënat e kolonës (3) duhet të korrespondojnë me çertifikatën familjare.

II. KUSHTET E STREHIMIT

Po Jo

2. Disponon banesë në pronësi.....

2.1. Në se **PO** jep informacionin e saktë mbi:

- Prona është e regjistruar në emër të (vendos referencën sipas kolonës (3) të tabelës “Gjendja familjare” _____
- Prona ka një strukturë:
 - Garsoniere
 - struktura e apartamentit 1+1
 - struktura e apartamentit 2+1
 - Struktura e apartamentit 3+1
- Sipërfaqja totale e banesës sipas dokumentit të pronësisë

- Sipërfaqja totale e banimit¹.....
2.2. Nëse jeni përgjigjur negativisht në pikën (2) vazhdoni me plotesimin e informacionit me poshtë:

- Banoj me qira

- Banoj me prinderit

- Banoj në banesë informale

2.3 Banoj në banesë rrezik shembje.....

2.4 Banoj në banesë të mbipopulluar

2.5 Kam mbetur i pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore

2.6 Kam mbetur i pastrehë nga procese gjyqësore

2.7 Banoj në banesë që priset/përjashtohet nga legalizimi.....

III KUSHTET FAMILJARE

Shëno vetëm në një kuti që i përshtatet kushtit tuaj familjar

3.1 Familje një prindërore që kam në ngarkim fëmijë

3.2 I/E moshuar që kam mbushur moshën e pensionit dhe nuk jam përzgjedhur për t'u strehuar në një institucion publik i përkujdesit shoqëror.....

3.3 Familje me më shumë se 4 fëmijë

3.4 Çift me moshë jo më të madhe se 60 vjeç

IV – KUSHTET SOCIALE

Shëno në kutitë që që i përshtaten kushteve tuaja sociale

4.1 Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara.....

4.2 Ka statusin e jetimit dhe moshë deri 30 vjeç

4.3 Mbetur i pastrehë për shkak të lirimt të banesës ish-pronarëve

4.4 Emigrant i ri-kthyer/ punëtor emigrant

4.5. Azilkërkues

¹ Në sipërfaqe totale të banimit futen sipërfaqja e dhomave të gjumit plus sipërfaqen e dhomës së ditës, të matura brënda mureve ndarës.

4.6 Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyr.....	<input type="checkbox"/>
4.7 Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH)	<input type="checkbox"/>
4.8 Punonjës i RENEA-s	<input type="checkbox"/>
4.9 Punonjës i Shpëtimit dhe Mbrojtjes nga Zjarri	<input type="checkbox"/>
4.10 Viktimë e dhunës në familje	<input type="checkbox"/>
4.11 Viktimë e trafikimit.....	<input type="checkbox"/>
4.12 Anëtar i minoritetit Rom	<input type="checkbox"/>
4.13 Anëtar i minoritetit Egjiptian	<input type="checkbox"/>
4.14 I mitur në konflikt me ligjin	<input type="checkbox"/>
4.15 Vajza- nëna	<input type="checkbox"/>
4.16 Komuniteti LGBTI	<input type="checkbox"/>
4.17 Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike	<input type="checkbox"/>

V TE ARDHURAT E FAMILJES

Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje në përputhje me kolonat (3) e (4) të tabelës “Gjendja Familjare”. Në të ardhura totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike, pensioni, dërgesa nga emigracioni, qira nga prona, transferta të tjera nga të afërm, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër që sigurohet mbi baza mujore ose vjetore nga trashëgimi, interesa bankare, etj. Me të ardhura neto kuptohen të ardhurat pas shlyerjes së detyrimeve si taksa, tatime e sigurime shoqërore.

- Të ardhurat totale mujore të familjes
- Të dhëna të detajuara të të ardhurave mujore të familjarëve sipas kolonës (3) të tabelës “Gjendja Familjare”
- 00 04 08
- 01 05 09
- 02 06 10
- 03 07 11
- Të ardhura nga emigracioni (vjetore)
- Të ardhura nga qira (mujore)
- Të ardhura të tjera (vjetore)

VI FORMA E TRAJTIMIT SIPAS NJERIT PREJ PROGRAMEVE SOCIALE TE STREHIMIT²

Unë dhe familja ime kërkoj të trajtohem me strehim nëpërmjet programit të:

(Rendit nga 1 deri ne 4 sipas preferencës: 1 per preferencën më të madhe; 4 për atë më të ulët)

- Banesë sociale me qira.....
- Banesë me kosto të ulët.....
- Tokë e pajisur me infrastrukturë për të ndërtuar vetë banesë.....
- Përmirësimi i banesës

Shënim: Forma e përfitimit mund të ndryshojë nga ajo që ju keni cilësuar si më të preferuarën, në varësi të mundësive të zgjidhjes dhe aftësisë financiare të familjes suaj për të përballuar kostot.

Në mungesë të banesave sociale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësia e vetëqeverisjes vendore ofron një nga instrumentet e mëposhtëm financiar. Nëse ju pranoni, duhet të shënoni:

- | | Pranoj | Nuk |
|---|--------------------------|--------------------------|
| | | pranoj |
| – Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi i qirasë në tregun e lirë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| – Në mungesë të banesave me kosto të ulët, ofrohet, sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave të kredive..... | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

Shtojca "B"

DEKLARATE E VERTETESISE SE INFORMACIONIT PARAPRAK

²Banesat e përkohshme dhe banesa e specializuar, si rregull propozohen nga bashkia për rastet e vécanta dhe nuk ofrohen si alternativa

DEKLARATE

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj sa më poshtë:

1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin KËRKESË PËR TRAJTIM ME STREHIM është i vërtetë.
2. Pranoj që, në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, të bëhet inspektimi në banesën ku banoj dhe verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë.
3. Jam në dijeni se, për çdo informacion të rremë, mua dhe anëtarëve të familjes sime, u hiqet e drejta për të përfituar strehim.
4. Jam në dijeni se, nëse përzgjidhem për tu trajtuar me strehim, struktura përgjegjëse për strehimin në bashki, bazuar në të dhënat mbi të ardhurat familjare, mund të më ofrojë një formë tjetër strehimi nga ajo që kam kërkuar në KREUN IV të këtij formulari.

Nënshkruar në _____, më _____

Deklaruesi: (Emër/Mbiemër/Firmë) _____

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PLOTËSOJË QYTETARET PËR PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TE QIRASE.

FAZA E PARË:

1. Certifikatë familjare .
2. Formular kërkesë për strehim.
3. Vertetim banimi (Bashkia Lezhë).
4. Vertetim nga ZVRPP Lezhë që nuk ka pronë të regjistruar ose në proces regjistrimi (për të gjithë anëtarët e familjes mbi 18 vjeç).

5. Vertetim nga zyra ALUIZNI-t Lezhë që nuk ka banesë në proces legalizimi (për të gjithë anëtarët e familjes mbi 18 vjeç).
6. Vertetim nga Drejtoria e Tatim Taksave që nuk ushtron aktivitet biznesi (për të gjithë anëtarët e familjes mbi 18 vjeç).
7. Vertetim për ndonjë status që mund të ketë nga institucioni që e trajton:
 - i verbër
 - jetim
 - paraplegjik tetraplegjik, të semurë mendorë.
8. Vertetim për të ardhurat që ka cdo anëtarë i familjes.
9. Vertetim nga zyra e punës për anëtarët e papunë të familjes

FAZA E DYTË:

1. Kontratë qeraje e noterizuar ku të cilesohet vlera e qirasë mujore dhe sipërfaqja e banesës me qira me m2.
2. Numri i llogarisë/ IBAN i qiradhënësit.

Komisioni i Strehimit shqyrtton aplikimet dhe përzgjedh aplikantët përfitues. Pas përfundimit të shqyrtimit të aplikimeve komisioni harton një raport përmbledhës i cili i paraqitet në Këshillin Bashkiak, për miratimin e listave përfundimtare të përfituesve të programit social të strehimit “Subvencionimi i Qirase”.

Kundër Vendimit të Këshillit Bashkiak për “Miratimin e listave të përfituesve të programit social të strehimit për “Subvencionimin i Qirase” mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente.

DOKUMENTACIONI PER PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TE INTERESAVE TE KREDIVE

Çdo aplikant së bashku me kërkesën e tij duhet të dorëzojë edhe dokumentat si më poshtë:

- (i) Formulari i strehimit i plotësuar pranë Bashkisë Lezhë;
- (ii) Çertifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;
- (iii) Vërtetimin për vendbanimin në Bashkinë Lezhë;
- (iv) Vërtetimin e të ardhurave neto të familjes/individit;
- (v) Dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- (vi) Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- (vii) Vërtetimin për anëtarët e familjes të përfshirë në pagesat për personat me aftësi të kufizuar nga zyra me një ndalesë në B.Lezhë dhe pagesat si kujdestar i PAK;

- (viii) Vërtetimin nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
- (ix) Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;
- (x) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret për strehim.
- (xi) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;
- (xii) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- (xiii) Dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;
- (xiv) Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;
- (xv) Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- (xvi) Vërtetimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara;
- (xvii) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
- (xviii) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë të Policisë së Shtetit, punonjësit e FNSH, RENEAS, Sherbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
- (xix) Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje;

Komisioni i Strehimit shqyrton aplikimet dhe përzgjedh aplikantët përfitues.

Pas përfundimit të shqyrtimit të aplikimeve komisioni harton një raport përmbledhës i cili i paraqitet në Këshillin Bashkiak, për miratimin e listave përfundimtare të përfituesve të programit social të strehimit "Subvencionimi i Interesave të Kredive".

Kundër Vendimit të Këshillit Bashkiak për "Miratimin e listave të përfituesve të programit social të strehimit për "Subvencionimin e Interesave të Kredive të Buta" mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente.